

**V E N D I M N r . 2**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**  
**``Dedolli 2015`` sh.p.k**

Sot, më **06/03/2026**, në **Klos,Mat**, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë **``Dedolli 2015`` sh.p.k.**, me seli në adresën: *Lagjja nr 1, Sheshi Ahmet*, Klos,Mat sipas njoftimit të bërë rregullisht dhe në përputhje me ligjin dhe aktet themeluese të shoqërisë, me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e **zmadhimit të kapitalit të shoqërisë**.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ``Dedolli 2015`` sh.p.k. nipt: L58604901R ne lidhje me zmadhimit te kapitalit të shoqërisë , me unanimitet :

**1. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë**

- a. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë për vlerën **10.000.000 (dhjete milion) lekë**.
- b. Zmadhimi i kapitalit do të kryhet **nëpërmjet kompensimit të detyrimit monetar** që shoqëria ka ndaj ortakut i cili rrjedh nga **fitimi i vitit ushtrimor 2025**, i pa tërhequr prej tij, sipas pasqyrave financiare të datës **31.12.2025**.
- c. Nga **fitimet totale te pashperndara deri ne vitin 2025** në vlerën **10.327.491 (10milion e treqind e njezet e shtate mije e katerqind e nentedhjete e nje) lekë**, vendoset shpërndarja si më poshtë:
  - o **10.000.000 (dhjete milion) lekë** do të përdoren për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë;
  - o **327.491 ( treqind e njezet e shtate mije e katerqind e nentedhjete e nje) lekë** do të përdoren për **rezerva të tjera**;



## 2. Mënyra e zmadhimit të kapitalit

Zmadhimi i kapitalit do të realizohet **pa kontribute të reja në para ose në natyrë**, por vetëm nëpërmjet **kompensimit të fitimit të pa tërhequr** deri në vitin 2025.

Zmadhimi i kapitalit kryhet **ekskluzivisht në favor të ortakut ekzistues**, pa nënshkrim kuotash nga persona të tretë.

## 3. Kuotat e kapitalit

- Numri i kuotave të kapitalit të shoqërisë **mbetet i pandryshuar**, pra **1 (nje) kuote kapitali**.

## 4. Vlera nominale e kuotave

- Vlera nominale e **një kuote kapitali**, nga **1.000.000 leke (nje milion) lekë** që ishte përpara zmadhimit, **rritet me 10,000,000 (dhjete milion) lekë**.
- Pas zmadhimit, **vlera nominale e një kuote kapitali bëhet 11.000.000 (njembedhjete milion) lekë**.

## 5. Kapitali i shoqërisë pas zmadhimit

- Kapitali i shoqërisë, nga **1.000.000 (një milion) lekë**, **zmadhohet në 11.000.000 (njembedhjete milion) lekë**.
- Kapitali i shoqërisë përbëhet si më poshtë:
  - Kapital në para: **11.000.000 (njembedhjete milion) lekë**
  - Kapital në natyrë: **0 lekë**





#### 6. Struktura e kapitalit dhe ortakëve

Pas përfundimit të procesit të zmadhimit të kapitalit, struktura e kapitalit të shoqërisë "Dedolli 2015" sh.p.k. paraqitet si më poshtë:

- Kapitali i shoqërisë: **11.000.000 leke** (njembedhjetë milion) lekë
- Numri i kuotave: **1 (nje)**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË ``Dedolli 2015`` sh.p.k.**

Ervist Dedolli

